

# PROBLEME DHE DISKUTIME

FATMIR AGALLIU

## MBI PJESËT E LIGJËRATËS NË GJUHËN SHQIPE

Shtruarja dhe diskutimi i çështjeve që kanë të bëjnë me pjesët e ligjëratës, kanë një rëndësi të veçantë si nga pikëpamja teorike, ashtu edhe nga ajo praktike. Nga zgjidhja e këtij problemi varet në një shkallë të madhe edhe ndërtimi i gjithë kursit të morfologjisë të gjuhës së sotme shqipe.

Në gjuhësinë shqiptare këto çështje deri më sot nuk janë bërë objekt trajtimi në një punim të veçantë. Nëpër gramatikat shkollore të kategorive të ndryshme është bërë edhe klasifikimi i fjalëve në pjesë të ligjëratës, por parimet nga është nisur ky klasifikim në përgjithësi<sup>1</sup> nuk janë parashtruar.

Në këtë artikull do të preken vetëm disa çështje që ngjallin diskutime dhe presin një zgjidhje sa më të argumentuar.

Përpjekjet e bëra në gjuhësinë e vendeve të tjera dhe, aty-këtu, edhe tek ne, kanë treguar se në klasifikimin e fjalëve në pjesë të ligjëratës është e pamundur t'i mbahemi vetëm një parimi. Këtu duhet marrë parasysh, veç kuptimit të përgjithshëm të një grupi të tërë fjalësh, edhe ana gramatikore, format morfologjike dhe kategoritë gramatikore tipike për këtë grup fjalësh, funksionet sintaksore themelore dhe lidhjet gramatikore karakteristike.

Kuptimi i përgjithshëm i një kategorie fjalësh, të cilin po e quajmë tipar semantik, duhet marrë kurdoherë në konsideratë, sepse, siç dihet, kuptimet gramatikore nuk ekzistojnë pa kuptimet leksikore; ato u nënshtrohen kuptimeve leksikore dhe shtresohen mbi to. Nga kjo pikëpamje pjesët e ligjëratës paraqiten si një zonë e ndërmjetme leksiko-gramatikore.

Kur flasim për tipar semantik, kemi parasysh kuptimin e përgjithshëm të një klase fjalësh, i cili ka karakter kategorial. Me gjithë karakterin e tij të përgjithshëm, ai mbetet një kuptim leksikor dhe nuk është e drejtë të quhet kuptim gramatikor. Kështu, në rastin e emrave kuptimi i sendësisë nuk mund të quhet kuptim gramatikor, sepse, si abstraksion, bazën ai e ka në kuptimin e veçantë të emrave, të cilët, në etapat e para të zhvillimit të gjuhës e të mendimit njerëzor shënonin sende. Me zhvillimin e mëtejshëm të mendjes së njeriut edhe shumë josome u konceptuan pikërisht si sende. Për mendimin tonë mbetet e drejtë vërejtja që bën Smirnicky rreth kësaj çështjeje: «Semantika e fjalës është e ndarë në dy pjesë: njëra i takon një fjale të veçantë, e veçanta, dhe përgjithshmja që i takon gjithë një grupi të caktuar fjalësh dhe paraqitet në çdo fjalë të veçantë si një «veshje kategoriale», në të cilën për-

1) Për herë të parë parimet e këtij klasifikimi dhe grupimi i mëtejshëm i pjesëve të ligjëratës janë dhënë në tekstin universitar *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe I* të Sh. Demirajt.

fshihet pjesa e veçantë, individuale e semantikës së fjalës»<sup>2</sup>. Çështja se cili nga parimet, ai semantik, morfologjik apo sintaksor del në plan të parë ose paraqitet edhe i vetmjaftueshëm, varet si nga veçoritë e një gjuhe, ashtu edhe nga pjesa e ligjëratës, për të cilën bëhet fjalë. Kështu, duke u mbështetur në parimin semantik, dallohen përgjithësisht mirë shumë pjesë të ligjëratës që ekzistojnë në gjuhën shqipe si emrat, mbiemrat, numërorët, foljet dhe ndajfoljet. Megjithatë, ana kuptimore është e pamjaftueshme, sepse, po të mbështetemi vetëm në të, nuk mund t'i zgjidhim dot të gjitha problemet, që dalin nga klasifikimi i fjalëve në pjesë të ligjëratës.

Kështu, përshebull, rrjedhoret pa parafjalë të emrave të pashquar shpeshherë kanë marrë kuptimin e mbiemrave relativë dhe nga kjo pikëpamje paraqiten gati si sinonimikë me ta. Mjafton të krahasojmë: *stoftë leshi*, *bukë misri*, *shtrat hekuri me stofë e leshtë*, *bukë e misërt*, *shtrat i hekurt*. Në këto raste si ana leksikore, ashtu edhe funksioni sintaksor nuk mjaftojnë. Vetëm forma morfologjike është ajo që dallon qartë këtu emrin nga mbiemri. Funksioni i njëjtë përcaktues dhe përdorimi i emrit të pashquar në rasën rrjedhore me një kuptim të përgjithësuar, i afron këta emra nga kuptimi me mbiemrat.

Vështirësi të veçanta paraqesin sidomos dallimet e kalimeve përfundimtare me anë të konversionit nga një pjesë e ligjëratës në një tjetër nga ato që janë ende në fazën tranzitore. Në këto raste problemi duhet hetuar nga të gjitha anët, duhen vështruar si veçoritë semantike, ashtu edhe ato formalo-gramatikore. Në grupe të ndryshme pjesësh të ligjëratës dalin në plan të parë herë njëri herë tjetri parim. Gjuha shqipe ka një strukturë morfologjike të zhvilluar, prandaj pjesët emërtuese të ligjëratës (emri, mbiemri, folja dhe ndajfolja) dallohen mirë prej njëra-tjetrës, duke u bazuar në tiparin semantik dhe në veçoritë morfologjike. Pjesët e pandryshueshme të ligjëratës, meqenëse s'kanë forma ndryshimi, është vështirë të dallohen prej njëra-tjetrës nga pikëpamja morfologjike. Ndajfolja, për vetë karakterin e saj emërtues dhe për lidhjet e saj sintaksore të veçanta, veçohet me lehtësi nga pjesët e tjera të pandryshueshme (parafjalët, lidhëzat), por jo gjithmonë pa vështirësi nga pjesëza. Në këto raste ana kuptimore dhe funksionale lozin rol përcaktues. Në dallimin e parafjalëve nga lidhëzat i vetmi kriter është funksioni i tyre i ndryshëm. Ana funksionale del në plan të parë edhe kur shqyrtohen raste të kalimit nga pjesë të tjera të ligjëratës në parafjalë ose në lidhëza. Kështu, shumë ndajfolje që kanë kaluar në parafjalë, e ruajnë kuptimin e tyre leksikor, por fitojnë një funksion tipik për parafjalën — drejtojnë rasën e një emri, duke e vënë në lidhje atë me një gjymtyrë tjetër të fjalisë. Kështu ndodh edhe me kalimin e një ndajfoljeje në lidhëzë (*Nga je? Nga fryn era, shkojnë retë*). Prandaj, kur shtrohet çështja për klasifikimin e pjesëve të ligjëratës në përgjithësi, është plotësisht i drejtë pohimi i Jespersenit se «duhet marrë parasysh gjithshka: edhe forma, edhe funksioni, edhe kuptimi.»<sup>3</sup> Kjo është edhe arsyeja që pjesët e ligjëratës duhen trajtuar si kategori leksiko-gramatikore e jo si kategori gramatikore<sup>4</sup>.

2) Smirnicki, *Leksikologija anglijskogo jazyka*, f. 152-153.

3) O. Jespersen, *Filosofojia grammatiki* (përkthim nga anglishtja), f. 65

4) Ky trajtim i pjesëve të ligjëratës si kategori gramatikore është përhapur në literaturën gjuhësore të kohëve të fundit. Ai gjendet edhe në tekste mësimore si në atë të Gollovinit *Vvedenie v jazykoznanie*, 1966, f. 165 e vijim.

\* \* \*

Çështjet e diskutueshme janë të shumta, por në këtë artikull do të trajtohen vetëm disa prej tyre.

Nga ana e veçorive morfologjike dhe e funksioneve sintaksore klasa e përemrave të gjuhës shqipe paraqitet mjaft heterogjene, ashtu siç ndodh në shumë gjuhë të tjera. Disa kategori përemrash i njohin të dyja funksionet, edhe atë të emrit, edhe atë të mbiemrit. Disa të tjerë përdoren ose vetëm si emra, ose vetëm si mbiemra. Përemrat me forma ndryshimi në funksion të mbiemrit (dëftorët, pronorët, disa përemra pyetës dhe të pacaktuar), ashtu sikurse mbiemrat, i përshtaten emrit në gjini, në numër dhe në rasë. Por nga tipi i kuptimit të përgjithshëm leksikor ata dallohen prej mbiemrave. Kjo gjë na detyron t'i trajtojmë si përemra në të dyja funksionet. Për shqipen ngre peshë në këtë mes edhe rrethana e njohur se midis përdorimit emëror dhe mbiemëror të një përemri nuk ka dallime në formën e fjalës. Kështu, përemrat dëftorë dhe pyetës kanë të njëjtat trajta në të dyja përdorimet. Dallohen vetëm pronorët, por edhe ky ndryshim nuk prek temën e fjalës; ai shfaqet vetëm në shquarësinë e tyre, e cila është pasojë e një substantivimi me karakter kontekstual. Në këtë pikë pronorët shkojnë paralel me mbiemrat, prandaj në planin morfologjik dhe sidomos në atë sintaksor ata meritojnë një trajtim të veçantë.

Në kategorizimin e përemrave mbështetja vetëm në kriterin gramatikor (morfologjik-sintaksor) do të prishte njësinë, sepse e njëjta fjalë me të njëjtat forma morfologjike, por me funksione sintaksore të ndryshme, do të përfshihej njëherazi në dy pjesë të ndryshme të ligjëratës. Kështu është vepruar zakonisht edhe nëpër gramatikat shkollore të gjuhës shqipe, të cilat, megjithatë, vetëm sa i kanë përmendur këta përemra në kapitullin e mbiemrit, por përshkrimin e formave morfologjike ua kanë bërë, kur i kanë analizuar si përemra.

Trajtimi i mjaft përemrave si mbiemra do ta bënte klasën e mbiemrave një grup tepër heterogjen e të larmishëm nga pikëpamja morfologjike. Vetëm përemri i *tillë*, pronorët e vetës së tretë me nyje të përparme i *tij*, i *saj*, i *tyre*, disa pronorë të vetës së parë e të dytë e *mi* (-a), e tu (-a) dhe pronori vetvetor i *vet* lakohen si mbiemrat. Disa përemra të tjerë si pyetësi *cili*, lidhori i *cili*, përemrat *gjithë*, *njëri* kur përdoren si emra, dhe derivatët e tyre lakohen si emrat. Midis përemrave ka edhe fjalë të pandryshueshme si lidhori *që*, i pacaktuari *çdo*, pyetësat *ç*, *cka*, *çfarë*. Pjesa tjetër e përemrave në përgjithësi ka një lakim të veçantë, karakteristik, të ndryshëm nga lakimi i emrave dhe i mbiemrave. Kjo rrethanë e fundit besojmë se përbën një argument të karakterit morfologjik në të mirë të trajtimit të përemrave si një pjesë me vete e ligjëratës. Megjithatë, ana leksikore këtu zë vendin e parë. Nga pikëpamja sintaksore gjithë përemrat bëjnë punën e emrave e të mbiemrave, por nuk kanë kuptimin e tyre. Kuptimi leksikor tepër i përgjithshëm, shpeshherë ai i të treguarit dhe vlera konkrete e ndryshueshme, u japin përemrave një vend me vete. Në shumicën e rasteve ata paraqiten si ekuivalentë emrash dhe mbiemrash, pa qenë as emra as mbiemra të vërtetë, sepse si kuptimin e sendësisë, ashtu edhe atë të tiparit, e kanë të kushtëzuar.

Prandaj kufizimi i klasës së përemrave vetëm në një grup jo të madh fjalësh, në ata që tregojnë persona (përemrat vetorë) dhe shpër-

ndarja e përemrave të tjerë në klasën e mbiemrave dhe të ndajfoljeve, nuk duket të jetë një zgjidhje e drejtë dhe bindëse<sup>5</sup>.

Në traditën gramatikore të gjuhës shqipe fjalët *shumë*, *pak*, *aq*, *kaq*, *mjaft* janë trajtuar edhe si ndajfolje sasive, edhe si përemra, përkatësisht mbiemra të pacaktuar (të pakufishëm). Kur përdoren si përcaktorë emrash, për t'i karakterizuar ata nga pikëpamja e sasisë, janë marrë si mbiemra të pakufishëm. Dallimi i tyre nga përemri është bërë mbi bazën e një analize kuptimore të sforcuar dhe sipas parimit të nënkuptimit (në fjalinë «*erdhën shumë*» fjala *shumë* është quajtur përemër, kurse në fjalinë «*punoj shumë*», ndajfolje).

Kalimi i një fjale nga një pjesë e ligjëratës në një tjetër shoqërohet me ndryshimin e kuptimit leksikor. Në rastin tonë kuptimi leksikor mbetet po ai, vetëm funksioni është i ndryshëm (fjala është për përdorimin si mbiemër i pakufishëm). Por ai nuk mjafton për të përcaktuar se kjo apo ajo fjalë i takon një pjese të caktuar të ligjëratës, sidomos kur kemi të bëjmë me një fjalë emërtuese si ndajfolja, roli i së cilës nuk kufizohet vetëm në të përcaktuarit e foljes. Për mendimin tonë këto fjalë mbeten ndajfolje edhe në funksionin mbiemëror. Për ndajfoljet *shumë*, *pak* dhe *mjaft* funksioni përemëror në fakt është i paqenë.

Fjalët *shumë* dhe *pak* edhe nga ana morfologjike ndryshojnë nga përemrat, sepse kanë shkallëzim edhe kur përdoren si mbiemra (*më shumë njerëz*, *më pak fjalë*). Përemrat, siç dihet, në të gjitha funksionet e tyre nuk kanë shkallëzim. Po të përdorej termi numëror me kuptimin e tij të gjerë, këto fjalë do të quheshin numërorë të pacaktuar. Përdorimi i tyre në funksion mbiemri dhe emri shkon paralel me atë të numërorëve (*erdhën dy shokë* — *munuan dy*, *erdhën shumë shokë* — *munuan shumë*). Kur substantivohen, ato nuk e kanë të pamundur edhe përdorimin në ndonjë rasë të zhdrejtë, si në dhanore (*dyve*, *shumëve*).

Nga ky grup ndajfoljet *aq* e *kaq* duhen dalluar, sepse ato kanë një kuptim përemëror (pronominal) në kuptimin e gjërë të këtij termi (*aq* e *kaq* duan të thonë, sipas rastit, një numër ose sasi çfarëdo, që përcaktohet nga konteksti ose rrethana e ligjëritimit). Me këto shkojnë edhe ndajfoljet *ashtu* e *kështu*, *këtu* e *aty*, *andej*, e *këtej*. Këtë e tregojnë edhe pjesëzat deiktike *a-* dhe *k(ë)-*, që i gjejmë tek këto ndajfolje dhe tek dëftorët *ai*, *ky*, *ata*, *këta*, *i atillë*, *i këtillë*. Ndajfoljet përemërore përbëjnë një problem me vetë, që kërkon një studim të veçantë.

Klasifikimi i fjalëve në pjesë të ligjëratës në një gjuhë duhet të mbështetet në analizën sinkronike të fenomeneve gjuhësore, në gjëndjen ekzistuese të gjuhës, d.m.th. në stadin e sotëm të zhvillimit të gjatë të saj, në të cilin kanë ndodhur kalime të shpeshta nga një pjesë e ligjëratës në tjetrën, ashtu siç ndodhin edhe sot. Lidhur me këtë meriton të diskutohet kategorizimi i disa fjalëve si *sëmurë*, *shëndoshë*, *gjallë* etj. Në të njëjtin funksion e njëjta fjalë me formësim gramatikore të ndryshme, tipike për dy pjesë të ligjëratës po të ndryshme<sup>6</sup>, duhet të diferencohet në një farë mase edhe kuptimisht.

5) Një mendim të tillë ka shprehur për përemrat e rusishtes Vinogradovi në veprën e tij *Russkij jazyk*, 1947, f. 42.

6) Këtë karakteristikë formale të ndryshme të mbiemrave nga ajo e ndajfoljeve e ka vënë në dukje kohët e fundit edhe E. Çabej: «Mendimi i Boppit... që adverbet nuk ndryshojnë në formë nga mbiemrat (f. 518; 495), për përdorimin e sotëm të gjuhës nuk është i drejtë. Këtu ka vlerë fjala e N. Joklit, që ky artikull (fletet për nyjen e përparme — *shënimi ynë*) është eksponenti i adjektivit». *Rreth disa çështjeve të historisë së gjuhës shqipe*, BUSHT, SSHSH, 3. 1963, f. 82).

Mbiemrat dhe ndajfoljet si fjalë që tregojnë cilësi, afrojnë midis tyre. Ky afrim bëhet i ndjeshëm sidomos në funksionin predikativ. Fjalët *gjallë, sëmurë, shëndoshë*, sipas mendimit tonë, sot kanë vlerën e ndajfoljes, me një përdorim të kufizuar kryesisht si gjymtyrë predikative.

Që të mohosh karakterin ndajfoljor të këtyre fjalëve, duhet të mohosh edhe përdorimin predikativ të ndajfoljes në shembujt *jam keq, jam mirë*, ku duket qartë se dallimi me *jam i keq, jam i mirë* nuk është vetëm morfologjik formal, por edhe kuptimor i thellë. Kundër kësaj mund të sillj si argument përdorimi i fjalëve *gjallë, shëndoshë, sëmurë* kryesisht si predikativë<sup>8</sup>. Përdorimi i kësaj apo asaj fjale me një rreth të caktuar fjalësh të tjera varet nga kuptimi leksikor i saj. Në të mirë të tezës sonë se këtu kemi të bëjmë me ndajfolje të përdorura për të treguar gjendje, vjen edhe pohimi se folja *jam*, me të cilën këto fjalë shkojnë shpesh, në funksionin e kallzuesit emëror nuk është e zhveshur semantikisht, por ruan kuptimin e ekzistencës, të qenjes. Kjo duket edhe në ballafaqimin e foljes me emrin foljor: *jam mirë, të qenët mirë, jam sëmurë, të qenët sëmurë*.

Megenëse diferencimi kuptimor i pasuar edhe nga diferencimi formal (ndajfolja pa nyje, mbiemri me nyje) përfshin gjithë klasën e ndajfoljeve dhe të mbiemrave, nuk mund të pranohen si mbiemra vetëm disa raste të veçanta përjashtimi dhe aq më pak edhe si mbiemra edhe si ndajfolje. Në goftë se do të bëhej fjalë për një kategori të gjëndjes, atëhere do të diskutohet çështja e një grupi të veçantë fjalësh. Por autori i këtij artikulli anon më shumë nga zgjerimi i funksionit të ndajfoljes, se sa nga veçimi i një grupi të ngushtë fjalësh.

Ky grup do të zgjerohej, po të shtiheshin këtu edhe pjesoret predikative: *dera u gjet hapur, derën e la mbyllur*, të cilat, sipas mendimit tonë, mbeten pjesore. Besoj se nuk kemi arsye të flasim për ndajfolje në këto raste të një përdorimi të kushtëzuar, ku semantika e mirëfilltë e fjalës errësohet nga kushtet e caktuara sintaksore. Po të krahasojmë *dera u gjet hapur* dhe *fliste hapur* duket qartë ndryshimi midis pjesores dhe ndajfoljes. Në këtë rast, vendimtarë janë funksioni sintaksor dhe tipari semantik, sepse nga ana morfologjike si pjesorja, ashtu edhe ndajfolja, janë fjalë të pandryshueshme.

Një çështje e diskutueshme, ende e pazgjidhur përfundimisht, është edhe ajo e nyjes.

Veçimi i nyjes se prapme si pjesë më vete e ligjëratës i takon anës historike të studimit të gjuhës, madje një historie tepër të largët<sup>9</sup> dhe bie në kundërshtim me analizën sinkronike të saj. Pranimi i lakimit të shquar pothuaj nga të gjithë ata që janë marrë me studimin e shqipes dhe dallimi i nyjes si pjesë më vete e ligjëratës përmbajnë kontradikta, që mund të zgjidhen po të trajtohet nyja jo si pjesë ligjrate, por si

7) Ndryshe mendojnë për këto fjalë Shaban Demiraj në veprën *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe*, II, f. 266 dhe Ali Dhrimo në artikullin *Mbi disa çështje të klasifikimit morfologjik të mbiemrave në shqipen e sotme letrare*, Studime filologjike<sup>1</sup>, 1969, f. 58 e 78.

8) Me sa duket Sh. Demiraj (po aty, f. 266) u njeh këtyre fjalëve edhe vlerë ndajfoljore në disa përdorime, që ai i interpreton si funksione sintaksore të ndryshme.

9) Për vjetërsinë e nyjes së prapme shih edhe E. Çabej, *art. i cit.* f. 79.

morfemë lakimi. Zbërthimi i formës *lis-i-t* (*breg-u-t*) në tri të dhëna: në temën e emrit, në mbaresën rasore të trajtës së pashquar dhe në nyjen shquese kërkon medoemos sqarime historike mbi rrugën e formimit të formave rasore të trajtës së shquar nga format korresponduese të së pashquarës me shtimin e artikullit në rasën përkatëse. Veç asaj nuk mund të quhet e provuar ende plotësisht që tingujt *-i* (*-u*) janë mbaresa rasore edhe në origjinë<sup>10</sup>. Në anën tjetër, kjo analizë mund të bëhet vetëm për lakimin mashkullor, sepse në lakimin femëror puna ndryshon. Këtu, në vend të mbaresës *-e*, ose kemi tingullin *ë*, ose nuk kemi fare tingull që t'i përgjigjet mbaresës së trajtës së pashquar, dhe nyja vjen menjëherë pas temës së emrit (*fishës, deles*).

Zbërthimi i ndryshëm i të dhënave *-it* (*ut*) dhe i të dhënave *-in* (*-un*) të kallëzores, duke dalluar tek këto të fundit një tingull pa funksion morfologjik<sup>11</sup>, përmban gjithashtu një kontradiktë tjetër.

Po të pranojmë që lakimi i shquar përbën një paradigmë të veçantë, baza e nisjes për të cilin është emërorja e shquar, ahëre për gjendjen aktuale të dhënat *-it*, *-ut* dhe aq më pak ajo *-ës* nuk ka arësye që të zbërthehen, përndryshe lakimi i shquar do të konceptohej si një aglutinim trajtash rasore të dy pjesëve të ligjëratës, të cilat edhe sot e gjithë ditën kuptohen nga disa gjuhëtarë si lakime dy fjalësh të ndryshme<sup>12</sup>.

Nyja shquese e shqipes njeh vetëm një pozicion, atë të prapmin dhe duke qenë fjalë shërbyese (si e tillë identike me një morfemë nga kuptimi) ajo mori edhe tiparet formale të një morfeme, sepse u ngjiti me fjalën, së cilës i përkiste. S. Frashëri, me të drejtë, kur analizon nyjet (të përparmet) thotë: «Nukë do të bëjmë fjalë këtu për nyjet që ngjitenë në funt t'emëravet, se ata më s'janë fjalë me vetëhehe, edhe u muarë vesh nga sa thamë në të bërët të rrënjevët»<sup>13</sup> (nënvizimi është yni, autori). Edhe në qoftë se identifikohet fonetikiisht me nyjen e përparme (*i miri*, të mirët (*ë*)), ajo dallohet kryekëput funksionalisht, sepse nyjet e përparme në shqipen e sotme nuk kanë funksion shques dhe nuk dihet në se e kanë pasur edhe dikur këtë funksion. Folja *kam*, në formimin e habitores, ruan plotësisht trajtën e saj fonetike (*dalkam*, *dalkë*, *dalka*, *dalkemi*, *dalkeni*, *dalkan*), por megjithatë nuk merret si fjalë, por si morfemë, sepse s'ka tiparet fonetike të një fjale, po ashtu edhe kuptimi i saj është gramatikor (dallon vetëm, numrin dhe jep idenë e një veprimi të papritur, që ngjall habi te folësi). Po ashtu edhe kuptimi i shquarësisë nuk është kuptim leksikor, por gramatikor, sepse një emër i shquar nuk ndryshon prej trajtës së tij të pashquar nga

10) Lidhur me këtë E. Çabej shkruan: «Nderkaq edhe të ky artikull disa forma janë inovacione sekundare. Kështu p.sh. *-i-ja* e gjindore-dhanores së shquar të mashkullores njëjës (*i*) *gur-i-t*, pas dëshimit që na japin emrat e afërisë (të birt, të vëllat, të shoqt), të cilat zakonisht janë konservative, nuk është e vjetër. Mendoj se kjo *-i-* hyri këtu nga emërorja e shquar ose nga gjindore-dhanorja e pashquar.» (po aty, f. 79).

11) Shih Shaban Demiraj, *vep. e cit.* pjesa I. f. 64; E. Lafe, *Hyrje në gjuhësi*, 1970, f. 157.

12) Shaban Demiraj në tekstin e morfologjisë ndryshe nga gjithë tradita gramatikore shqipe, lakimin e shquar e ndau nga ai i pashquari dhe e trajtoi tek nyja (*vepër e cituar*, I, f. 63 e vijim). S. Riza (*Emrat në shqipe ...*, 1965, f.39) dhe E. Lafe (*vepër e cituar*, f. 157) bëjnë fjalë për një lakim të nyjes së prapme. E. Lafe pohon nga ana tjetër se ka mendime që nyja nuk përbën një pjesë me vete të ligjëratës (po aty, f. 167).

13) S. Frashëri, *Shkronjëto e gjuhës shqip*, Bukuresht, 1986, f.26.

ana leksikore, por vetëm sipas rrethanës në se bëhet fjalë për një send të njohur apo të panjohur. Kjo vlerë e nyjes shquese përfshihet brenda sferës së kuptimeve gramatikore.

Pra nyja shquese nuk ka as tiparet fonetike as ato kuptimore të një fjale a fjalëze. Ndryshe qëndron puna me trajtën e shkurtër të përemrit vetor, e cila vihet edhe para edhe pas emrit, duke pasur po atë trajtë fonetike dhe po atë kuptim tregues (si përemër) në të dy pozitat: *hape derën, mos e hap derën*.

Pra, në pikëpamje sinkronike, zgjidhja më e drejtë do të ishte heqja e nyjes së prapme nga pjesët e ligjëratës<sup>14</sup> dhe trajtimi i lakimit të shquar në vetvete, d.m.th. shpjegimi i rasave të lakimit të shquar si formime me formante të veçanta. Për emërtimin e njësive *-i, -it, (-ut), -in(-un), -(j)a, -(ë)s, -(ë)n(ë), -t(ë)*<sup>15</sup> propozoj termin *mbaresë shquese*<sup>16</sup> i cili jep në të njëjtën kohë si karakteristikën formale ashtu edhe një element themelor të funksionit të tyre.

Shquarësia dhe pashquarësia (ose siç është thënë zakonisht trajta e emrit) do të merren si një kategori gramatikore e emrit<sup>17</sup>. Nyjet e përparme mund të mbahen si një pjesë më vete e ligjëratës, por karakteri heterogjen i kuptimeve dhe i funksioneve të tyre e bën të vështirë një karakterizim të përgjithshëm, që të përfshijë gjithë përdorimet e nyjeve të përparme. Më drejtë do të ishte që ato të futeshin në grupin e pjesëzave fjalëformuese dhe formëformuese. Puna e lakimit nuk përbën pengesë, sepse pjesëzat ndahen si pjesë më vete e ligjëratës për kuptimet dhe funksionet e tyre dhe jo sepse janë të pandryshueshme. Ndarja e fjalëve në të ndryshueshme dhe të pandryshueshme është një ndarje e bërë në bazë të kriterit morfologjik, ndërsa ndarja në emërtuese dhe shërbyese bëhet në bazë të kriterëve të tiera e të ndryshme.

Në klasën e mbiemrave, sipas traditës, janë përfshirë edhe format mbiemërore të pjesores (të ashtuquajturat pjesore të nyjzëzuara). Kjo zgjidhje na duket e drejtë, sepse trajtat dhe kategoritë gramatikore të tyre janë të një natyre tipike mbiemërore. Por duhet pasur parasysh se jo të gjitha pjesoret e nyjzëzuara nga pikëpamja kuptimore janë plotësisht të adjektivuara: shpeshherë ato ruajnë vlerën foljore dhe në këto raste s'kanë mundësi shkallëzimi, ashtu sikurse edhe mbiemrat relativë, me të cilët afrohen, sepse tregojnë një raport ndaj veprimit (lugë e *drunjte* dhe lugë e *bërë* prej druri). Edhe lidhjet sintaksore të këtyre trajtave janë tipike për pjesoren në përgjithësi dhe për pjesoren pësore në veçanti (mundësia për të marrë plotësa rrethanorë ven-

14) Të njëjtin mendim ka shprehur edhe M. Çeliku në artikullin *Disa vërejtje kritike për gramatikat shkollore, në revistën «Lëndët shoqërore në shkollë»*, 6, 1969.

15) Në gjindore — dhanoren e shquar shumë trajta me *-vet* nuk përdoret më, prandaj këto dy rase formulisht dalin njëlloj në të dyja trajtat.

16) Termi *mbaresë-nyjë* që propozon S. Riza (*vep. e cituar*, f. 30), për emërtimin e tyre është i kritikueshëm nga pikëpamja teorike, sepse kur flasim për nyje, kemi parasysh një fjalë, e cila në të njëjtën kohë s'mund të jetë edhe mbaresë.

17) Për këtë shih edhe Sh. Demiraj, *Rreth kategorisë së shquarësisë e të pashquarësisë në gjuhën shqipe*, Studime filologjike, 4, 1969. Mbi pranimin e kësaj kategorie në emrat e gjuhës shqipe është shqiptuar së pari A. V. Desnickaja në artikullin *«Mbi strukturën morfologjike të gjuhës shqipe»* (përkthyer dhe botuar në BUSHT..SSHSH, 3, 1959), e cila pohon po aty (f. 222) se nyjet postpozitive «janë shkruar me temën e fjalës në një tërësi» dhe «janë shndërruar kështu prej një fjale shërbyese dikur të pavarur në një afiks formal».

di e kohe, plotësa mënyre, për t'u përcaktuar nga plotësi i vepruesit). Duke u përdorur në funksionin e një cilësoni të zgjeruar, format mbiemërore të pjesores, në sajë të kuptimit të tyre foljor, kanë një predikativitet të theksuar, që shfaqet sidomos kur ato veçohen.

Neve na duket se pjesorja e gjuhës shqipe nuk mund të ndahet si një pjesë me vete e ligjëratës, sepse nuk ka as tregues formalë, as kategori gramatikore të vetat, prandaj ajo duhet integruar në sistemin foljor. Kjo është edhe arsyeja që format mbiemërore të pjesores, që kanë kuptim dhe reksion foljor, nuk mund t'i lëmë brenda sistemit foljor. Sikurse mbiemri, ato ndryshojnë sipas gjinisë, numrit e rasës, duke ju përshtatur emrit. Në përdorimet e ndryshme të saj, pjesorja e mirëfilltë pa nyje të përparme nuk ka as gjini, as numër dhe nuk lakohet, megjithëse mund të paraqitet me funksionin sintaksor të një mbiemri. (Le të krahasojmë këta dy shembuj: 1) Dhe m'u bë sikur nëpër ato bisqe aq të bukura, *ngarkuar* me halthe të gjelbëra e me rrëshirë të murme, nisën të më rendnin disa përfytyrime që më pri-shën mendjen fare. — S. Andoni; 2) Krahi i mëngjër i ushtrisë turke, — F. Noli). Ndryshimet e vlerës leksikore, që pasqyrohen edhe në ndryshimin e lidhjeve gramatikore, do të vështrohen si shfaqje polisemie tek e njëjta fjalë (krahaso: shtëpi e *djegur* dhe i *djegur* prej qullit, i fryn kosit — proverb popullor). Mbeten për t'u studjuar më tej veçoritë e këtyre mbiemrave si nga ana kuptimore ashtu edhe gramatikore. Midis mbiemrave të tjerë ato meritojnë një trajtim të veçantë<sup>18</sup>.

Këtë vështirim mbi pjesët e ligjëratës në gjuhën shqipe po e mbylлим duke trajtuar edhe një problem tjetër të vështirë, atë të dallimit të disa ndajfoljeve nga emri. Fjala është për rastet e kalimit të disa trajtave rasore të emrit me ose pa parafjalë në ndajfolje. Këta emra mund të jenë si të trajtës së pashquar, ashtu edhe të trajtës së shquar. Në rastet kur kemi emra konkretë sendesh, përcaktimi i çështjes nëse kemi të bëjmë me një emër në një rasë të caktuar, apo me një ndajfolje është më i lehtë, sepse duket qartë që emri e ka humbur kuptimin e tij si emër, që ai nuk tregon më një send. Ndajfolje të tilla janë, për shembull, fjalët: *sheshit* (dolën sheshit), *copë* (ia tha copë), *rreth* (i erdhi rreth), *rrotull* (i erdhi rrotull), *këmbë* (ecën këmbë) etj. Në rastet *pushave*, *maleve* (*maleve* bie dëborë; bridhte *pushave*) mendoj se nuk kemi arsye të shëndosha për të folur për ndajfolje. Këto konstruktë janë të barasvlefshme me konstruktet parafjalore *nëpër fusha*, *nëpër male*. Në të dy rastet emri e ruan funksionin e tij si emërtues sendi.

Funksioni sintaksor nuk duhet marrë gjithnjë si përcaktues. Në emrat abstraktë që tregojnë periudha kohe, puna është më e vështirë. Por edhe këtu ka raste të qarta si, përshembull, fjala *heret*, e cila, me formën e saj tashmë arkaike, ka kaluar plotësisht në ndajfolje. Lidhia me emrin këtu është plotësisht e shkëputur. Një gjë e tillë ka ndodhur

18) Kësaj çështjeje i ka kushtuar vëmendje edhe Shaban Demiraj, kur shkruan: «Në raste të tilla duhet pasur parasysh se pjesorja, sadoqë ka marrë formën e një mbiemri të nyjshëm, nga ana semantike nuk ka kaluar në kategori-në e mbiemrave». (*Morfologji e gjuhës së sotme shqipe*, I, 1970, f. 84). Siç e sqaruar edhe më sipër, ana semantike këtu nuk është e mjaftueshme për t'i karakterizuar këto fjalë si mbiemra, sepse klasa e mbiemrave të nyjshëm dallohet nga ajo e pjesoreve me të njëjtën temë në shqipen e sotme nga prania e nyjes së përparme, e cila është eksponent i mbiemrit.

edhe me kallëzoret e shquara *natën, ditën*. Për të provuar karakterin e tyre emëror sillet si argument pranimi i mbiemrit<sup>19</sup>, por nuk duhet harruar se midis «Natën fle mirë» dhe «Natën e kaluar fjeta mirë», vënja e mbiemrit lidhet me ndryshime të theksuara në kuptim. Në raste të tilla e parë emri ka marrë një kuptim tepër të përgjithshëm; ai karakterizon veprimin nga pikëpamja e kohës. Këtu nuk bëhet më fjalë për një natë të caktuar, si në shembullin e dytë, por vetëm për kohën e kryerjes së veprimit. Në këto raste kuptimi leksikor i emrit, tregimi i një koncepti abstrakt kohe, nëpërmjet përdorimit të gjatë sintaksor të fjalës pranë foljes, për ta karakterizuar atë, u transfigurua, humbi lidhjen me sendin dhe fjala fitoi një vlerë ndajfoljore. Këtu në pikëpamje të gjenezës funksioni sintaksor ka luajtur një rol themelor, por në gjëndjen e sotme ai është i pamjaftueshëm për të përcaktuar vlerën e vërtetë reale të këtyre fjalëve si pjesë të ligjëratës. Veç kuptimit të përgjithshëm leksikor, që lot rol themelor, na vjen në ndihmë edhe morfologjia. Një veçori morfologjike me rëndësi e emrit është përdorimi i tij në rasta të caktuara me parafjalë. Në shembullin «Natën e kaluar fjeta mirë» vendosja e parafjalës *në*, megjithëse është e panevojshme, prapë nuk është e pamundshme, kurse në shembullin «Natën fle mirë» është e pamundur të përdorim parafjalën *në*.

Megjithatë mbeten edhe mjaft raste të vështira e të diskutueshme dhe kjo lidhet me vetë natyrën e rasave të zhdrejta të emrit, të cilat priren nga pjesë të tjera të ligjëratës.

Një veçori morfologjike me rëndësi e ndajfoljes, që ajo e ka të përbashkët me mbiemrin, është kategoria e shkallës. Në gjuhën shqipe gjithë grupet leksikore të ndajfoljeve mund të formojnë shkallë. Ndajfolje të veçanta nga secili grup nuk kanë shkallë.

Fjala *më*, sipas mendimit tonë, edhe kur përdoret si fjalë shkalle, e ruan kuptimin e saj ndajfoljor. Funksioni sintaksor i njëjtë i një ndajfoljeje të mënyrës dhe i një emri me parafjalë në funksion të plotësit të mënyrës, i jep mundësi folësit që, edhe para konstruktit emër me parafjalë të vendosë fjalën e shkallës *më* si në shprehjet *më me guxim, më me trimëri, më me shpejtësi* etj. Në përdorim i tillë është i mundshëm edhe me plotësa vendi: *më nga e djathta, më nga e majta, më nga lindja, më nga perëndimi* etj. Por kjo nuk don të thotë se këto konstrukte janë adverbializuar. Ndajfolja e sasisë *më* këtu karakterizon rrethanën ose tiparin, tani të shprehur io më nga një ndajfolje, por nga një pjesë tjetër e ligjëratës në funksion sintaksor ndajfoljor. Fakti që emrat në këto konstrukte marrin një përcaktor emëror me parafjalë, provon se këtu kemi të bëjmë me emra dhe io me ndajfolje (*më nga e djathta e rrugës; më nga lindja e qytetit* etj.).

Mjaft nga këta emra kanë përgjithësisht kuptimin e një tipari<sup>20</sup> ose veprimi abstrakt dhe kjo, mendojmë, jep mundësi edhe për shkallëzim sasior. Të tillë janë emrat *vendosmëri, guxim, seriozitet, sinqeritet, përgjegjësi, shpejtësi padurim* etj., Për shembull: «... të bëjnë përpjekje për ta pregatitur dhe dhënë mësimin në një mënyrë shumë më

19) Shih Sh. Demiraj, *Morfologji e gjuhës së sotme shqipe*, II, f. 260-261 dhe artikullin e tij *Rreth ndajfoljezimit të disa formave gramatikore dhe të disa tregjeve të tipit parafjalë + emër*, Studime filologjike, 1, 1970. Në këtë artikull jepet edhe një pasqyrë e plotë e pikëpamjeve të shprehura nga gramatikanët shqiptarë lidhur me përkatësinë kategoriale të këtyre fjalëve.

20) Për përdorimin e emrave në format e shkallëve të krahasimit shih edhe O. Jespersen, *Filosofoja grammatiki* (përkthim rusisht), 1958, f. 88.

të kualifikuar se sa gjer më sot, në qoftë se ata do të punojnë më intensivisht dhe më me përgjegjësi për t'u transmetuar studentëve dijenitë e tyre shkencore dhe teorike, ...» (M. Shehu, Mbi revolucionarizimin e sistemit arësimor, Buletin 5, 1968, f. 31). «Më me forcë dhe më tepër se kurrë sot duhet të kujtojmë e të vëmë në jetë porosinë e V.I. Leninit se nuk është marksist ai që nuk është ateist...» (Zëri i Popullit, 4 qershor 1969, f.2). «Ajo ecte përpara më me guxim se i shoqi, po dora e vogël i dridhej në dorën e tij». (F. Gjata, Këneta, 1959, f. 460). Këtu përfshihen edhe disa fjalë të parme, që, duke u përdorur në një kuptim të figurshëm, shërbejnë si karakterizues cilësorë të veprimit. «Një nga fqinjët, më me zemër, hapi dritaren dhe vështroi jashtë» (M. Kuteli, Netë shqiptare, 1944, f. 138); «Më fort e më me zjarr nga të gjithë kërcente një djalosh thatim me fytyrën të gjerë poshtë e të ngushtë lart» (M. Kuteli, Në një cep të Ilirisë së poshtëme, Nëndori, 6, 1965, f.31).

Shtrirja e shkallëzimit në plotësit rrethanorë të formuar nga një emër me parafjalë është mjaft e gjerë, sidomos në publicistikën e sotme, por analiza e hollësishme e tyre do të kërkonte një studim të veçantë.

Emri mund të fitojë shkallëzim edhe atëhere kur përdoret si përkaktor i një emri tjetër me parafjalën *me* si në shprehjet «njerëz më me autoritet», «argument më me peshë» etj. Por në këto raste ne nuk mund të flasim për mbiemra, veç së tjerash, edhe për faktin se atyre u mungon trajta morfologjike mbiemërore dhe kategoritë gramatikore tipike për mbiemrin. Përdorimi me shkallë krahasimi është karakteristik për emrat që dallojnë cilësi.

Emri mund të shkallëzojë cilësinë që shpreh, edhe në funksion predikativ si në shprehjet «Është më në gjendje» «Është më shtazë nga të gjithë», «X-in e kam më shok se të tjerët».

\* \* \*

Për mendimin tonë në gjuhën e sotme shqipe duhen dalluar këto pjesë të ligjëratës:

1) Emri, që tregon një send (në kuptimin e gjerë të fjalës) ose veprime, gjendje dhe cilësi të sendëzuara. Për emrin në gjuhën shqipe janë karakteristike kategoritë gramatikore të gjinisë, numrit, rasës dhe kategoria gramatikore e shquarësisë dhe e pashquarësisë. Kjo e fundit u takon gjithë emrave<sup>21</sup>, duke përfshirë edhe të përveçmit<sup>22</sup> dhe ata që tregojnë lëndë, sepse gjen shprehje në përdorimin e tyre në të dy trajtat, megjithëse bazën ajo e ka tek emrat që tregojnë sende të numërueshëm, të cilët formojnë një klasë të përbërë prej ekzemplarësh, që mund të dallohen prej të tjerëve dhe të individualizohen.

2) Mbiemri, që tregon një veti të sendit dhe përshtatet me emrin në gjini, në numër dhe rasë<sup>23</sup>. Në klasën e mbiemrave do të përfshihen edhe pjesoret mbiemërore.

21) Shaban Demiraj në artikullin *Rreth kategorisë së shquarësisë e të pashquarësisë në gjuhën shqipe*, «Studime filologjike», 4, 1969, mendon se këtë kategori nuk e kanë të gjithë emrat, por vetëm emrat e përgjithshëm, kur përdoren me kuptim të individualizuar.

22) Përdorimi i disa emrave të personave të seksit femëror vetëm në trajtën e shquar (*Tefta, Violeta, Suzana* etj.) duhet mënjanuar si një veçori e gjuhës së folur.

23) Nga përshtatja në rasë përjashtohen mbiemrat e panyjshëm, të cilët në shqipen e sotme nuk kanë lakim.

3) Numërori, që tregon një numër abstrakt ose sasi të sendeve. Kemi parasysh këtu vetëm themelorët.<sup>24</sup>

4) Përemri në të gjitha funksionet e tij. Në klasën e përemrave duhet të përfshihet edhe vetvetori *vete-vetja*, që ka formën dhe funksionet e emrit si edhe përemri i identitetit *vetë*<sup>25</sup>. Substantivimet e pronorëve do t'i trajtojmë bashkë me të tjerët si substantivime të karakterit gramatikor, të një natyre me ato të mbiemrave brenda një fjalisë të caktuar.

5) Folja, që tregon një veprim si proces dhe ka kategoritë e diatezës, mënyrës, kohës, vetës dhe numrit. Në klasën e foljeve duhen përfshirë edhe pjesorja si edhe shprehjet foljore të formuara me pjesëmarrjen e saj (*me punue, pa punuar, duke punuar*) dhe të trajtës së substantivuar të pjesores (*për të punuar, me të ardhur, një të ardhur*).

6) Ndajfolja;

7) Parafjala;

8) Lidhëza;

9) Pjesëza.

Në klasën e pjesëzave do të futen fjalëzat që shprehin nuanca kuptimore plotësuese ose kuptime të ndryshme modale. Në këtë klasë mund të përfshihen gjithashtu edhe pjesëzat trajtëformuese, midis tyre edhe të ashtuquajturat nyje të përparme<sup>26</sup>, si edhe ato që quhen pjesëza fjalëformuese (*di, do*)

10) Pasthirma.

24) Për rreshtorët autori pajtohet me zgjidhjen e dhënë në konspektin e *Gramatikës shkencore të gjuhës shqipe* për t'i përfshirë në klasën e mbiemrave.

25) Në përdorimet e tipit «dera u hap vetë» këtë fjalë ne do ta trajtojmë si ndajfolje.

26) Të ashtuquajturat nyje të përparme i ka përfshirë në klasën e pjesëzave edhe M. Çeliku në artikullin e cituar.

